

Njohuritë dhe qëndrimet e adoleshentëve për problemin e narkomanisë



Ulqin,
tetor - dhjetor 2015

SHENIME HYRËSE

Organizata e shoqërisë civile HORIZONTI I RI, në bashkëpunim me Zyrën për parandalimin e narkomanisë në komunën e Ulqinit, në periudhën tetor-dhjetorë të vitit 2015, ka realizuar një hulumtim kualitativ, me qëllim që të analizojë nivelin e njohurive dhe të informimit të adoleshenteve në Ulqin për aspekte të ndryshme në lidhje me problemin e narkomanisë.

Hulumtimi është bërë në mënyrë anonime, duke aplikuar tekniken e pyetësorit dhe të intervistës, në një mostër prej 300 nxënësish. Mostrën e kanë përberë nxënësit e klasave të nënta nga dy shkollat fillore të qytetit si dhe nxënësit nga të dy shkollat e mesme në territorin e komunës së Ulqinit.

Në shkollat fillore të përzgjedhura (Marshall Tito dhe Boshko Strugar) janë anketuar të gjithë nxënësit e klasës së nëntë të cilët kanë atë ditë kanë ndodhur në shkollë. Të dhënat janë mbledhur me anë të pyetësorit. Në shkollat e mesme (Vëllazërim-Bashkim dhe Gjumnazi DRITA) janë përdorur teknikat e kombinuara të pyetësorit dhe të intervistës.

Për realizimin e këtij hulumtimi kemi anketuar nxënës të moshave 14-18 vjeç, për shkak të moshës në të cilën kryesisht ndodhin ndryshime në qëndrimet e tyre dhe në sjellje.

Hulumtimin e njohurive dhe qëndrimeve të të rinjve të Ulqinit rreth problemit të abuzimit me droga, Horizonti i Ri e ka filluar para shumë vitesh. Kështu anketimin e parë e kemi realizuar në vitin 2004, kur janë anketuar 324 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme. Kjo njëherësh shënoi edhe fillimin e partneritetit të suksesshëm në këtë fushë, të OJQ-ve dhe institucioneve në nivel lokal (Policisë, Shtëpisë së shëndetit, Qendrës për Punë Sociale, institucioneve të arsimit dhe aktorëve të tjerë). Hulumtimi i dytë është bërë në vitin 2009, kur kemi anketuar 210 nxënës.

Përmes këtyre tre hulumtimeve kemi përfshirë gjithsej 834 nxënës në territorin e komunës së Ulqinit.

Kësaj here (2015), anketimi i të rinjve shkollorë për problemin e narkomanisë në nivel lokal, paraqet një pjesë të projektit të gjerë **“PARTNERITETI LOKAL KUNDËR ABUZIMIT TË DROGAVE DHE DELIKUENCËS SË TË MITURVE”**, të cilin Horizonti i Ri e realizon me mbështetje të Ambasadës së SHBA në Podgoricë, përmes Byrosë për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit.


Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është ngritja e vetëdijes së të rinjve në lidhje me efektet e dëmshme të abuzimit me droga si dhe ulja e shkallës së sjelljeve antisociale dhe delikente në mesin e të rinjve në komunitetin lokal.

Qëllimet specifike të projektit janë: krijimi i partneritetit lokal me institucionet relevante në luftën kundër abuzimit me droga dhe kriminalitetit *të të miturve, mbështetje për Pushtetin Lokal në aktivizimin e Zyrës për parandalimin e narkomanisë, hartimi i Planit Lokal për parandalimin e sëmundjeve të varësisë.*


Në kuadër të këtij projekti është krijuar edhe Rrjeti i partnerëve lokal të cilin e përbëjnë: Komuna e Ulqinit (Zyra për parandalimin e narkomanisë), Gjykata Themelore në Ulqin, Prokuroria Shtetërore në Ulqin, Qendra për Punë Sociale në Ulqin, Policia në Ulqin, Shtëpia e Shëndetit në Ulqin dhe OJQ “Horizonti i Ri”.

Për realizimin e suksesshëm të këtij projekti veçanërisht falënderojmë drejtuesit e shkollave, pedagogët, psikologët, të rinjtë vullnetarë dhe të gjithë partnerët tjerë lokal të cilët kanë bashkëpunuar me shumë dëshirë dhe kanë ofruar mbështetje të çmueshme.


1. Sipas mendimit tënd, sa është droga e rrezikshme?



2. Sa lloj drogash njeh?




3. A mendon që marihuana është drogë?




4. A është e lehtë të gjejsh drogë në ambientin ku ti jeton / mëson?




5. A e din që droga është e ndaluar me ligj?




6. A i njeh denimet që pasojnë nëse përdorë drogë?




7. Pse, sipas mendimit tënd, të rinjtë fillojnë të marrin drogë?




8. A ke përdorur ti ndonjëherë drogë, pa e ditur se çfarë është?




9. A mendon se edhe ti mund të kesh problem me drogë, nese vihesh në provë për ta provuar?




10. Si do ta njihje narkomanin, nga çka?



11. A njuh ti ndonjë person që merr drogë?




12. Kur je në shoqëri me njerëz që marrin drogë?




” **Diçka tjetër:** nuk shoqërohem me njerëz të tillë, i shmangem asaj shoqërie, frikësohem prej tyre, etj.

13. Sikur të merrje vesh që shoku / vellai yt merr drogë, kujt do t'i tregoje për këtë?




” **Diçka tjetër:** ndoshta do t'i tregoja dikujt, do ta këshilloja që ta linte drogen (pa i treguar askujt)

14. Sa je i informuar për substancat narkotike?




15. Nga e merr ti më së shpeshti informacionin?




” Diçka tjetër: nga shkolla, nga prindërit


16. Sipas mendimit tënd, kush është më kompetent të flasë për këtë problem?



17. A ekzistojnë tek ne institucione që merren me shërimin e përdoruesve të drogave?



18. A e ke provuar ti (ndonjëherë) ndonjë llojë droge?



” **PO:** *marihuanë, ekstazi, ...*

PYETËSORI

ANKETË ME NXËNËS TË SHKOLLAVE FILLORE dhe TË MESME

Të lutemi që të marrësh pjesë në këtë anketim, i cili ka për qëllim të shqyrtojë se sa të rinjtë e komunës tonë kanë njohuri për drogat, çfarë mendojnë për përhapjen e tyre dhe a kanë përvoja personale me këtë fenomen. Të lutemi që të përgjigjesh sa më sinqerisht në pyetjet e parashtruara, në mënyrë që të fitojmë një pasqyrë sa më reale të situatës.

Anketimi është ANONIM

1. Sipas mendimit tënd, sa është droga e rrezikshme?

- a) nuk është e dëmshme
- b) pak e dëmshme
- c) e dëmshme
- d) nuk e di / nuk jam i sigurt

2. Sa lloj drogash njeh?

- a) asnjë
- b) 1-5
- c) 5-10
- d) më shumë se 10

3. A mendon që **marihuana** është drogë?

- a) po
- b) jo
- c) nuk e di

4. A është e lehtë të gesh drogë ne ambientin ku ti jeton / mëson?

- a) po
- b) jo
- c) nuk jam i sigurt

5. A e din që droga është e ndaluar me ligj?

- a) po
- b) jo
- c) nuk e di

6. A i njeh dënimet që pasojnë nëse përdor drogë?

- a) po
- b) jo
- c) nuk jam i sigurt

7. Pse, sipas mendimit tënd, të rinjtë fillojnë të marrin drogë?

- a) mungesë njohurie dhe informacioni
- b) problemet në shkollë dhe në familje
- c) kureshtja
- d) dëshira për t'u dalluar në shoqëri
- e) _____ (diçka tjetër)

8. A ke përdor ti ndonjëherë drogë, pa e ditur se çfarë është?

- a) po
- b) jo
- c) nuk jam i sigurt

9. A mendon se edhe ti mund të kesh probleme me drogë, nëse viresh në situatë për ta provuar?

- a) po
- b) jo
- c) nuk e di /nuk jam i sigurt

10. Si do ta njihje personin që merr drogë, nga çka?

- a) nuk do ta njihja
- b) nga sytë
- c) nga sjellja
- d) nga veshja
- e) _____ (nga diçka tjetër)

11. A njeh ti ndonjë person që merr drogë?

- a) po
- b) jo
- c) nuk jam i sigurt

12. Kur je në shoqëri me njerëz që përdorin drogë ...

- a) të pengon
- b) të disponon
- c) s'të paraqet problem
- d) _____ (diçka tjetër)

13. Sikur të merrje vesh që shoku/vëllai yt merr drogë, kujt do t'i tregoje për këtë?

- a) jo, nuk do t'i tregoja askujt
- b) prindërve
- c) shokëve të tjerë
- d) _____ (dikujt tjetër)

14. Sa je i informuar për substancat narkotike?

- a) nuk jam i/e informuar
- b) pjesërisht jam i/e informuar
- c) kam informacion të mjaftueshëm

15. Nga e merr më së shpeshti informacionin ?

- a) nga mjetet e informimit (mediat)
- b) nga rrethi shoqëror – nga miqtë
- c) _____ (nga dikush tjetër)

16. Sipas mendimit tënd, kush është më kompetent të flasë për këtë problem?

- a) prindërit
- b) shkolla
- c) ekspertët
- d) mediat
- e) ata që dikur kanë konsumuar drogë
- f) _____ (dikush tjetër)

17. A ekzistojnë tek ne institucione që merren me shërimin e përdoruesve të drogave?

- a) po (cilat?) _____
- b) jo
- c) nuk e di

18. A ke provuar ti (ndonjëherë) ndonjë lloje droge? (*Mendohet edhe në të ashtuquajturat "droga të lehta"*)

- a) po (cilën?) _____
- b) e kam provuar, por nuk vazhdoj ta marrë?
- c) jo

ANALIZA E ANKETIMIT

Narkomania si dukuri meriton kujdes të vazhdueshëm dhe angazhim maksimal në vetëdijesimin e të rinjve si dhe në formimin e qëndrimeve dhe aftësive rezistuese ndaj drogave.

Studime dhe kërkime të kësaj problematike Horizonti i Ri i bën vazhdimisht duke krijuar strategji për parandalimin e këtij fenomeni.

- Hulumtimi i bërë së fundmi në një mostër prej 300 të rinjsh jep një pasqyrë të përafërt me gjendjen aktuale. Nga hulumtimi i rezultateve vazhdimisht na shfaqet një numër i vogël nxënësish të cilët nuk e konsiderojnë drogën si të dëmshme (6%), që kanë provuar drogë (10%), që nuk e konsiderojnë marihuanën si drogë (12%). Hulumtimet tregojnë se fillimi i drogës para moshës 15 vjeçare është parashikues i qëndrueshëm për abuzim me droga më vonë. Kjo dmth. se nëse përdoruesi apo eksperimentuesi i drogës është në shkollën fillore, ai ka gjasa që edhe më vonë të vazhdojë këtë rrugë.
- Në qëndrimin - kur jemi në shoqëri me njerëz që marrin drogë “disponohemi”, janë përgjigjur pozitivisht (7%) dhe ‘nuk paraqet problem’ (26%), paraqet rritje nga viti 2009 (kur të anketuarit janë përgjigjur me 3% - të disponon dhe 10% s’të paraqet problem), duhet të theksojmë se të rinjtë që kanë qëndrim pozitiv ndaj drogave si dhe të rinjtë që nuk iu pengon të shoqërohen me përdorues drogash (33%), kanë probabilitet që edhe vet të përfshihen në sjellje të njëjta.
- Rezultati shqetësues që në dy hulumtimet e fundit, qëndron në faktin se 47% e të anketuarve njohin dikë që përdor drogë, (në v. 2009 = 51%), pastaj 31% e të anketuarve janë përgjigjur se është lehtë të gjesh drogë në ambientin ku jeton. Faktori i dytë më me rëndësi për nga rrezikshmëria që të rinjtë të bëhen abuzues të drogës është mundësia për të gjetur drogë. Duke pasur këtë rezultat, i pashmangshëm është detyrimi ynë që të rinjtë t’i përfshijmë në strategji ndërgjegjësuese dhe parandaluese. Njohja me dikë që përdor drogë apo dijenia se ku mund të gjesh drogë, gjithmonë paraqet një rrugë alternative që në momentin e caktuar mund të bëhet shtysë ose faktor rreziku për një të ri.
- Fakti që 60% e të anketuarve janë përcaktuar se do t’u tregonin prindërve sikur të kuptonin që shoku/vëllai i vet merr drogë, i shërben faktorit mbrojtës për fëmijët. Hulumtimet tregojnë se aty ku ekziston marrëdhënia e mirë, lidhja me prind, mbrojtja e fëmijës është me e sigurt, ose aty ku marrëdhënia është e çrregulluar, ka konflikt dhe nuk ka kontroll, predispozitat janë më të mëdha që fëmija të jetë në rrezik edhe nga përdorimi i drogave.

Vlen të theksohet se hulumtimet japin mesazhe të forta dhe të qëndrueshme në lidhje me marrëdhënien prind - fëmijë dhe abuzimet me droga.

- 12% e të rinjve të anketuar nuk e konsiderojnë marihuanën si drogë, paraqet rritje nga viti 2009, kur vetëm 2% ishin të këtij mendimi. Nëse analizojmë këtë fakt, mund të themi se kjo fatkeqësisht vjen si një “trend” i kohës, nga reklamimi i çuditshëm pozitiv që i bëhet kësaj droge, duke përdorur shenjën e saj në lokale, veshje, këngë, etj. Në këto lloj fushatash, mediat e shkruara dhe televizive, paraqesin njerëz me influencë për të rinjtë si përdorues të saj, etj.

Studimet tregojnë se përdoruesit e marihuanës, hashashit dhe gjithë spektrit të kanabis, heqin kuriozitetin për drogat, por njëkohësisht me marihuanën ata ngjisin shkallën e parë të përdorimit të drogave. Në situatën kur marihuana bëhet e pamjaftueshme për të marrë ndjenjë dhe eksperiencë të mira, këta përdorues kalojnë në droga më të rënda.

- Shumë pyetje nga anketimi kanë të bëjnë me atë se sa janë të informuar të rinjtë me fenomenin e drogës, psh. të dëmshme e konsiderojnë 79% e të anketuarve; 81% njohin nga 1 – 10 lloje drogash; 72% kanë informacion apo kanë pjesërisht informacion mbi këtë çështje. Problemi qëndron se nga ku dhe në çfarë mënyre informohen të rinjtë rreth problemit të drogave, pasi ky fakt paraqet një problematikë në vete.

Te kjo pyetje, 54% e të rinjve informacionin e kanë nga mediat, nga rrethi shoqëror informohet 39% e tyre, ndërsa vetëm 7% përmendin shkollën dhe prindërit.

Informimi i mirëfilltë i të rinjve kërkon kujdes të posaçëm, për arsye se informimi i pjesërishtëm mund të ngjallë më shumë kuriozitet/kureshtje tek të rinjtë se sa vetëdijesim. Kështu që asnjë program në shkollë apo jashtë saj, i ndërmarrë për të informuar të rinjtë mbi drogat, nuk do të jetë i suksesshëm nëse bazohet në atë se vetëm informimi është strategji parandalim.

Përkundrazi, hulumtimet tregojnë se programet parandaluese duhet të përmbajnë qasje të cilat mësojnë të rinjtë rreth ndikimeve sociale për t'u angazhuar në përdorimin e drogës dhe trajnimin e aftësive rezistente ndaj presioneve të ndryshme apo ndikimeve sociale.

Përveç kësaj, faktorët rrezikues mund të trajtohen qysh në kohën parashkollore apo në shkollimin e hershëm, siç janë sjelljet agresive, aftësitë sociale jo të mira, vështirësia në të mësuar etj, të cilët njihen edhe si faktor rreziku për përdorimin e drogave në një moshë më të vonshme.

Horizonti i Ri ka plot 12 vite që trajton këtë problematikë dhe çdoherë përpiqet që me punën e vet të çojë mesazhin e duhur në institucionet përkatëse, tek të rinjtë dhe tek prindërit.

Ardita Kovaçević,
Psikologe

HULUMTIM I NJOHURIVE DHE QËNDRIMEVE TË TË RINJVE NË ULQIN PËR PROBLEMIN E NARKOMANISË

Periudha e realizimit:

Tetor – Dhjetor 2015

Ekipi realizues:

Nazif Veliq

Rajka Prodanoviq

Arben Husiq

Biljana Bevenja

Blerim Gjeloši

Ilijana Boci

Admira Selmanoviq

Ekipi i profesionistëve:

Ardita Kovaçeviq, psikologe

Mehmet Duraku, sociolog

Mrijana Mijoviq, pedagoge

Ekipi i anketuesve në terren:

Arlinda Osmanoviq

Lenka Llalloviq

Irhad Çota

Mark Luliq

Selma Mujiq

Zahide Lleshi

Flaka Avdiu

Besart Hoxha

Sabina Kurti

Qeveria	01.01.2007	01.01.2008	01.01.2009	01.01.2010	01.01.2011
Shërbimet	150	147	141	139	137
Shërbimet tregëtare	135	132	125	123	121
Shërbimet financiare	15	15	16	16	16
Shërbimet tjera	0	0	0	0	0
Transporti	150	150	150	150	150
Total	150	150	150	150	150



OJQ Horizonti i Ri
Kodra pn
85360 Ulqin
Telefon: +382 (0)68 300 603
E-mail: horizon@t-com.me
www.ngo-horizonti.org